

STATUTI I SHOQATËS ALUMNI

1) Shoqata ALUMNI

Shoqata ALUMNI është pjesë e strukturave të Universitetit POLIS. Ajo e ushtron veprimtarinë e saj në koordinim të ngushtë me organet drejtuese të Universitetit POLIS. Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të saj përcaktohen në paragrafët e mëposhtëm.

2) Anëtarësia

a) Çdo student i cili zotëron një diplomë të Universitetit POLIS ose është në vitin e fundit të studimeve në Universitetin POLIS, Tiranë, i lind e drejta të bëhet anëtar i Shoqatës ALUMNI pas pagesës së tarifës së anëtarësimit të parashikuar në klauzolën 2 (c).

b) Çdo ish-student, anëtar i stafit akademik apo administrativ i Universitetit POLIS i cili nuk i plotëson kushtet e mësipërme si në 2 (a), por që, me rekomandimin e Bordit Ekzekutiv, është pranuar nga Shoqata dhe ka paguar tarifën e anëtarësimit siç është përkrahur në pikën 2 (c).

c) Tarifa e anëtarësisë përcaktohet rast pas rasti nga bisedimet midis Universitetit POLIS dhe Shoqatës. Për vitin e parë të funksionimit të shoqatës ALUMNI, tarifa e anëtarësimit do të jetë 1000 (njëmijë) lekë.

3) Të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve

Të gjithë anëtarët e shoqatës kanë të drejtë:

a) të jenë përfitues të mundshëm të ndonjë prej skemave apo programeve të asistencës të administruar nga Shoqata.

b) të përfitojnë bursa studimi.

c) të ekspozojnë punët e tyre në qendrat MAD dhe asetet e tjera të Universitetit POLIS.

ç) të marrin pjesë në jetën sociale dhe aktivitetet e U_POLIS, Metro_POLIS, Co_PLAN, etj.

d) të angazhohen në projekte të ndryshme të U_POLIS, Metro_POLIS sipas nevojave dhe duke ju nënshtruar përzgjedhjes nga U_POLIS dhe Metro_POLIS.

dh) të njoftohen lidhur me aktivitetet e Shoqatës dhe gjithashtu të marrin pjesë në të gjitha funksionet shoqërore të Shoqatës.

e) Të përfitojnë botime/revista të Universitetit POLIS me cmim të subvencionuar.

Të gjithë anëtarët e shoqatës janë të detyruar të:

a) të paguajnë tarifën e anëtarësisë të përcaktuar sipas pikës 2 (c).

b) të mundësojnë mbarëvajtjen e shoqatës ALUMNI.



Handwritten signatures in blue ink, including the name "Murim B. Do" and other illegible signatures.

4) Organizimi

Organet drejtuese të Shoqatës janë:

1. Asambleja e Përgjithshme
2. Bordi Ekzekutiv
3. Kryetari

Mënyra e zgjedhjes së organeve të mësipërme dhe kompetencat e tyre janë të përcaktuara në paragrafët e mëposhtme.

5) Asambleja e Përgjithshme

a) Asambleja e Përgjithshme do të përbëhet nga të gjithë anëtarët e Shoqatës, siç përcaktohet në pikën 2 (a) dhe 2 (b).

b) Asambleja e Përgjithshme duhet të marrë parasysh raportin e Kryetarit të Shoqatës për aktivitetet e vitit të kaluar, buxhetin dhe planin e aktiviteteve për vitin e ardhshëm, miratimin e llogarive, zgjedhjen e anëtarëve të Bordit Ekzekutiv dhe çdo çështje tjetër rast pas rasti.

c) Asambleja e Përgjithshme do të mbledhet në muajin Dhjetor përveç rastit kur ndryshimi i datës u është njoftuar anëtarëve më parë. Ky takim referuar si Mbledhja e Përgjithshme Vjetore do të shqyrtojë çështjet e mëposhtme:

- i) Miratimin e llogarive të vitit të mëparshëm.
- ii) Zgjedhjen e anëtarëve të Bordit Ekzekutiv.
- iii) Miraton Statutin e Shoqatës Alumni dhe ndryshimet e mundshme të saj.
- iv) Çështje të tjera të propozuara për shqyrtim nga të paktën 1/10 e anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme.


ç) Kuorumi për zhvillimin e mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme do të jetë jo më pak se 1/2 e të gjithë anëtarëve. Në rast se kuorumi nuk është i plotë, kryetari do ta shtyjë takimin dhe Asambleja do të rimbledhet në një kohë të mëvonshme. Pas kësaj mbledhje do të quhet e rregullt pavarësisht numrit të anëtarëve të pranishëm.

d) Asambleja e Përgjithshme merr vendim me shumicë të thjeshtë votash (50% +1) të votave të anëtarëve të pranishëm. Në rast të barazisë së votave, vota e Kryetarit është vendimtare.

6) Bordi Ekzekutiv

Bordi Ekzekutiv do të përbëhet nga 6 anëtarë të zgjedhur nga Asambleja e Përgjithshme, pjesë e të cilit është dhe Kryetari i shoqatës. Anëtarët e Bordit Ekzekutiv do të zgjidhen në detyrë për një mandat 3-vjeçar. Anëtarët e Bordit Ekzekutiv duhet të jenë studentë ose ish-studenë me rezultate të larta të cilët kanë marrë pjesë në mënyrë aktive në jetën akademike dhe sociale të Universitetit POLIS. Asambleja e Përgjithshme do të zgjedhë anëtarët e Bordit Ekzekutiv nga mesi i anëtarëve të shoqatës me shumicën e votave.

Bordi Ekzekutiv mbledhet sa herë kërkohet nga çdo anëtar i saj, por jo më pak se katër herë në vit. Bordi Ekzekutiv është autoriteti ekzekutiv i Shoqatës dhe ushtron kompetencat e mëposhtme:


Merim B. Shu

- a) Koordinon veprimtarine me Rektoratin e U_POLIS dhe me organet e tjera drejtuese të Universitetit POLIS.
- b) Harton politika për lehtësimin e punësimit të studenteve të diplomuar nga Universiteti POLIS.
- c) Promovon bursa studimi.
- ç) Organizon ekspozimin e punëve të studenteve të diplomuar në qendrat MAD dhe asetet e tjera të Universiteti POLIS.
- d) Organizon pjesëmarrjen e studenteve të diplomuar në jetën sociale dhe aktivitetet e U_POLIS, Metro_POLIS, Co_PLAN, etj.
- dh) Eshtë përgjegjës për menaxhimin e financave dhe fondeve të Shoqatës.
- e) Siguron zbatimin e planeve dhe programeve të Shoqatës.
- f) Mban librat e llogarive të Shoqatës.
- g) Zgjedh Kryetarin e shoqatës në bashkëpunim me Rektoratin, Administratorin dhe Kancelarin e Universitetit POLIS.
- gj) Propozon ndryshime në Statutin e Shoqatës Alumni.
- h) Mban korrespondencën në emër të Shoqatës.

Bordi Ekzekutiv cakton ndarjet e detyrave për secilin anëtar, ku të paktën një anëtar është përgjegjës për mbajtjen e regjistrit të anëtarësimit dhe arkëtimet (Sekretari) në favor të Shoqatës ALUMNI.


7) Kryetari

Kryetar i Shoqatës zgjidhet për një periudhë 3 vjecare me shumicën e votave të organeve të mëposhtme:

- a) Bordit Ekzekutiv
- b) Rektoratit të Universitetit POLIS
- c) Administratorit të Universitetit POLIS
- c) Kancelarit të Universitetit POLIS

Kryetari miraton kriteret për ndarjen e burimeve financiare dhe vlerëson efikasitetin e përdorimit të fondeve dhe zbatimin e buxhetit.

Kryetari ushtron kontroll të përgjithshëm në të gjitha çështjet e politikës së Shoqatës. Aktivitetet rutinë dhe administrimi i përgjithshëm i planeve dhe programeve do të mbikëqyren dhe koordinohen nga Bordi Ekzekutiv.



Handwritten signatures of board members, including the name Merim B. Liso.

8) Financa

- a) Shoqata mund të marrë fonde, donacione, dhe ndihmë financiare nga burim të ndryshme për përparimin e objektivit të saj.
- b) Universiteti POLIS mund të financojë deri në 50 % të aktiviteteve të shoqatës ALUMNI në rastet kur këto aktivitete përputhen me misionin dhe objektivat e Universitetit POLIS.
- c) Të gjitha paratë e marra në emër të Shoqatës do të vendosen në emër të Shoqatës Alumni në një llogari dhe do të ruhen në një bankë që do të miratohet nga Bordi Ekzekutiv. Kryetari i Shoqatës në bashkëpunim me një anëtar të Bordit Ekzekutiv (Sekretari) do të kryejnë disbursimet nga llogaria e Shoqatës ALUMNI, pasi janë koordinuar me përfaqësuesin e Zyrës së Financës të Universitetit POLIS.
- ç) Viti financiar i Shoqatës do të përfundojë më 31 Dhjetor.

9) Përkufizime

- a) "Shoqatë" do të thotë Shoqata ALUMNI në Universitetin POLIS.
- b) Universiteti do të thotë Universiteti POLIS, Tiranë, Shqipëri.
- c) "Kryetari" nënkupton Kryetarin e Shoqatës.
- ç) "Bordi Ekzekutiv" do të thotë Bordi Ekzekutiv i Shoqatës.
- d) ALUMNI do të thotë një ish student i cili zotëron një diplomë nga Universiteti POLIS ose student i vitit të fundit të studimeve në Universitetin POLIS, Tiranë.
- dh) Viti financiar i Shoqatës do të llogaritet çdo vit nga 1 Janar - 31 dhjetor .

10) Miratimi dhe hyrja ne fuqi

- a) Ky statut u miratua nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqatës ALUMNI.
- b) Statuti mund të ndryshohet sipas procedurave dhe me shumicën e kërkuar në këtë Statut.
- c) Ky statut hyn në fuqi më 31 Janar 2012.

Përfaqësues së Asamblesë së Përgjithshme:

Z.Gjergji Dushniku
Znj.Lisana Piro
Z.Glodian Dauti
Znj.Nevin Bilali
Znj.Joleza Koka

Gjergji Dushniku
Lisana Piro
Glodion Dauti
Nevin Bilali
Joleza Koka